



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME
Nr.01-060/01-6871/23 datë:10.03.2023



Npi – 01/84 datë: 15.03.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Nenin 11.1 të Rregullores Komunale për Transparencë Npi– 01/205 datë: 14.07.2017; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Si dhe Vendimi Kryetarit të Komunës Nr.02/296 i datës 27.02.2023, për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit për Integritet 2023-2027, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 15.03.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
DRAFT- PLANIN KOMUNAL PËR INTEGRITET 2023-2027

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 15.03.2023, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin Komunal për Integritet 2023-2027, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Administratë të Përgjithshme dhe Zyra për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi